

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-054/2014

Prishtinë, 14 prill 2016

Në çështjen juridike të:

M.S.

Ljubić Kej, Soliter 5, Apartamenti nr. 49
Čačak,
Serbi
Pala ankuese

Kundër

1. Sh.B.

Arbanë 518/2
Prizren

dhe

2. I.K.

Prizren

Palët përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Anders Cedhagen, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) nr. KPCC/D/A/204/2013 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA19199, KPA19200, KPA19201 dhe KPA19202), të datës 11 qershor 2013, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 14 prill 2016, ne mënyrë jo unanime mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Gjykata Supreme bashkon ankesat e M.S., të regjistruara nën GSK-KPA-A-054/2014, GSK-KPA-A-055/2014, GSK-KPA-A-056/2014 dhe GSK-KPA-A-057/2014, në një lëndë të vetme me numër të lëndës GSK-KPA-A-054/2014.
2. Miratohet si e bazuar ankesa e M.S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/204/2013 të datës 11 qershor 2013.
3. Ndryshohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/204/2013, i datës 13 qershor 2013, për sa i përket kërkesave të regjistruara në AKP nën KPA19199, KPA19200, KPA19201 dhe KPA19202, me sa vijon:
 - a. M.S. e ka vërtetuar se J.S. është pronare e ngastrave kadastrale me numrat 518/1, 518/2, 518/4, 519/1 dhe 519/2 në Fletën Poseduese nr. 78/Certifikata mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme UL-71813023-12175, Komuna e Prizrenit, Zona Kadastrale Dushanovë;
dhe urdhëron që:
 - b. J.S. ka të drejtë ri-posedimi të atyre ngastrave;
 - c. Çdo person tjetër që i ka uzurpuar këto ngastra duhet t'i liroj ato ngastra brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dorëzimi i këtij urdhri;
 - d. Nëse ndonjë person tjetër që i ka uzurpuar ngastrat nuk zbaton këtë urdhër për të liruar ato brenda afatit të lartcekur, ai apo ajo do të dëbohet nga ngastrat.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 24 nëntor 2006, M.S., (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka paraqitur katër kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), të regjistruara nën KPA19199, KPA19200, KPA19201 dhe KPA19202 si anëtar i familjes së ngushtë dhe në emër të nënës së tij J.S. (në tekstin e mëtejme gjithashtu: nëna e palës ankuese), ku kërkon ri-posedimin e ngastrave të përmendura në paragrafin 3 më poshtë (në tekstin e mëtejme të gjitha së bashku: prona e kërkuar). Ai thekson se nëna e tij është pronarja.

2. Në këto kërkesa fillimisht theksohet se pronat e kërkuara ishin humbur për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99, ku ceket data 13 qershor 1999 si data e humbjes. Pala ankuese gjithashtu ka theksuar se pronat e kërkuara janë të uzurpuara nga I.K. i cili kishte bartur të drejtën pronësore në emrin e tij në vitin 2005, bazuar në një kontratë të jashtëligjshme të shitblerjes pa dijeninë dhe miratimin e nënës së tij si pronare.

Sipas fletës poseduese nr. 78 të lëshuar nga Departamenti i Kadastrit dhe Gjeodezisë i Republikës së Serbisë më 13 mars 2006, pronat e kërkuara janë të regjistruara si më poshtë:

Numri i ankesës dhe i lëndës së AKP-së	Të dhënat e ngastrave të kërkuara
GSK-KPA-A-054/14 (KPA19199)	Fleta poseduese nr. 78, ngastra nr. 518/1, në vendin/rrugën e quajtur “Selo Okučnica”, livadh i klasës së 3-të dhe tokë jopjellore, me sipërfaqe prej 00.06.58 ha, Komuna e Prizrenit, Zona Kadastrale Dushanovë.
GSK-KPA-A- 055/14 (KPA19200)	Fleta poseduese nr.78, ngastra nr. 518/2 në vendin/rrugën e quajtur “Selo Kod Kuče”, tokë pjellore e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 00.01.20 ha, Komuna e Prizrenit, Zona Kadastrale Dushanovë.
GSK-KPA-A-056/14 (KPA19201)	Fleta poseduese nr. 78, ngastra nr. 518/4 ¹ , në vendin/rrugën e quajtur “Selo Okučnica”, livadh i klasës së 3-të dhe shtëpi dhe objekte, me sipërfaqe prej 00.05.80 ha, Komuna e Prizrenit, Zona Kadastrale Dushanovë.
GSK-KPA-A-057/14 (KPA19202)	Fleta poseduese nr.78, ngastrat me numrat 519/1 dhe 519/2, në vendin/rrugën e quajtur “Selo Kod Kuče”, pemishte e klasës së tretë, me sipërfaqe prej 00.05.20 plus 00.04.80 ha, së bashku 00.10.00 ha, Komuna e Prizrenit, Zona Kadastrale Dushanovë.

3. Për të mbështetur kërkesën e tij, pala ankuese ka dorëzuar *inter alia* dokumentet vijuese:

¹ KKPK i referohet vetëm 00.05.20 ha dhe nuk përmend shtëpinë por nga fleta poseduese e dorëzuar shihet qartë se sipërfaqja e kësaj ngastre është 00.05.80 dhe përveç livadhit ngastra është e regjistruar edhe me një shtëpi.

- Vendimin e korigjuar trashëgimor të lëshuar nga Gjykata Komunale e Prizrenit, të datës 21 prill 1994, nr. C. 32/94; në këtë vendim nëna e palës ankuese shpallet si trashëgimtare e pronave të kërkuara.
- Fletën poseduese nr. 78 që përmendet në paragrafin 2.
- Ekstraktin e Librit Amë të të Lindurve nr. 06 200 1 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil e Komunës së Gjakovës më 13 janar 1999, i cili dëshmon lidhjen familjare në mes të palës ankuese dhe J.S. .
- Autorizimin, të vërtetuar me numrin II-757/2003 në Gjykatën Komunale në Kragujevc, Serbi, më 25 dhjetor 2003 (në tekstin e mëtejme: Autorizimi); sipas këtij dokumenti J.S. e ka autorizuar A.S. për të shitur pronat e kërkuara në emrin e saj dhe për llogari të saj. Në këtë kuptim A.S. ishte autorizuar të lidh kontratë të shitjes, ta vërtetoj kontratën para gjykatës kompetente dhe të kryej të gjitha veprimet ligjore në mënyrë që blerësi të bëhet pronar i pronave të kërkuara. Autorizimi është nënshkruar si me gjurmë gishti ashtu edhe me nënshkrim.
- Deklaratën mbi shitjen e vullnetshme të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Kragujevc nën nr. II-758/2003 më 25 dhjetor 2003; sipas këtij dokumenti J.S. deklaron se pronat e saj të paluajtshme të regjistruara në fletën poseduese nr. 78 janë të lira dhe mund të shiten në bazë të autorizimit të lëshuar për A.S. dhe se kjo deklaratë jepet pa shtrëngim apo kërcënime dhe se ajo vullnetarisht kishte dhënë autorizimin. Deklarata nënshkruhet si me anë të gjurmës të gishtit ashtu edhe përmes nënshkrimit.
- Anulimin e Autorizimit të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Kragujevcit nën nr. 20/04; me këtë anulim J.S. kishte tërhequr autorizimin e saj të dhënë për A.S. . Dokumenti është i vitit: 2003, data dhe muaji janë të palexueshëm. Anulimi është nënshkruar si me anë të gjurmës së gishtit ashtu edhe përmes nënshkrimit.
- Anulimin e deklaratës mbi shitjen e vullnetshme të pronës të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Kragujevc nën nr. II-21/2004 më 25 dhjetor 2003; J.S. tërheq deklaratën e saj lidhur me shitjen e vullnetshme të ngastrave të regjistruara në fletën poseduese nr.78. Dokumenti është i vitit: 2003, data dhe muaji janë të palexueshëm. Anulimi është nënshkruar si me anë të gjurmës së gishtit ashtu edhe përmes nënshkrimit.
- Kontratën e shitjes së paluajtshmërisë, të datës 27 janar 2004, të vërtetuar nga Gjykata Komunale e Prizrenit më 29 janar 2004, me nr. 421/2004; sipas këtij dokumenti J.S. , e

përfaqësuar nga A.S. , ia kishte shitur pronat e kërkuara O.C., M.C., H.C., M.C., për 140.000 Euro.

- Fletën poseduese nr.78 të lëshuar më 25 janar 2005 nga Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Prizrenit; në këtë fletë poseduese pronat e kërkuara janë të regjistruara në emër të I.K. t (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë 2).
 - Një Raport ‘Të gjeturat e ekspertit’, nga L.L., Ekspert i Gjykatës në fushën e Grafologjisë dhe Traseologjisë në Beograd, të datës 28 prill 2005; ai thekson, në mendimin e tij të ekspertit, se nënshkrimet në Autorizimin e dhënë dhe Deklaratën mbi shitjen e vullnetshme dhe të dy Anulimet nuk janë nënshkruar nga J.S. dhe nënshkrimi në Kontratën e Shitjes të paluajtshmërisë nuk është dhënë nga A.S. .
 - Vendimin nr. P-117/05 (K-117/05) të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Kragujevc më 30 tetor 2006 me të cilin ishte shqiptuar një urdhër ndalim i përkohshëm për sa i përket tjetërsimit, pengëlënies apo ndërtimit të objekteve të reja në ngastrat 518/1, 518/2, 518/4, 519/1 dhe 519/2. Sipas vendimit, masa e lartpërmendur është shqiptuar ndaj palës përgjegjëse në ankesë 2 (“posedues-pronar i pronës”) dhe do të mbetet në fuqi deri në një vendim përfundimtar në procedurën penale kundër të pandehurës M.M. dhe të tjerëve lidhur me dyshimin e bazuar të kryerjes së veprës penale të shpërdorimit të pozitave të tyre zyrtare.
 - Aktgjykimin nr.1 P-6/10 (nr. 1 K-6/10) të datës 19 prill 2012, të lëshuar nga Gjykata e Lartë në Kragujevc me të cilin M.M. dhe M.D.janë gjetur fajtor për veprën penale të shpërdorimit të pozitave të tyre zyrtare, falsifikim të Autorizimit dhe tjetërsim të pronave të kërkuara. M.M. ishte dënuar me 10 muaj burgim ndërsa M.D.ishte dënuar me 6 muaj burgim, dhe njëkohësisht ato ishin urdhëruar të kompensojnë M.S. në shumën prej 9.627.618 Dinarë (valutë serbe) ndërsa në rast të kërkesave të tjera S. ishte udhëzuar në procedurë të rregullt civile.
 - Aktgjykimin nr. 4576/12 të lëshuar nga Gjykata e Apelit në Kragujevc më 18 dhjetor 2012: Gjykata kishte anuluar Aktgjykimin nr. 1 P-6/10 (Nr. 1 K-6/10) të datës 19 prill 2012 dhe lënda ishte kthyer në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.
4. Të gjithë dokumentet e lartpërmendur ishin gjetur pas verifikimit të bërë nga AKP-ja. Gjithashtu, AKP-ja *ex officio* kishte siguruar Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UI-71813023-12175, ku ceken pronat e kërkuara në emër të një personi të tretë me emrin D.Xh. . Sipas raportit të verifikimit të datës 21 prill 2011, J.S. fillimisht ia kishte shitur pronat O.C.,

M.C., H.C., M.C., bazuar në kontratën e shitblerjes Vr.Nr.412/04, të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prizrenit më 27 janar 2004. Ky i fundit, bazuar në kontratën e shitblerjes Vr.Nr.4377/04 të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prizrenit më 23 shtator 2004, ia kishte shitur pronat palës përgjegjëse në ankesë 2. Pastaj, pala përgjegjëse në ankesë 2 ia kishte shitur pronat e njëjta D.Xh. në bazë të Kontratës së shitblerjes Vr.Nr.7922/2010 të datës 14 shtator 2010, të vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prizren.

5. Më 18 maj 2010, AKP kishte kryer identifikimin e pronave të kërkuara në kërkesat KPA19199 dhe KPA19200 të cilat ishin gjetur të uzurpuara nga Sh.B. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë 1) i cili kishte pretenduar se ka interes ligjor ndaj pronave të kërkuara. Prona e cila ishte subjekt i shqyrtimit në kërkesën nr. KPA19202 ishte identifikuar më 2 janar 2007 ndërsa saktësia e raportit të identifikimit ishte vërtetuar më 2 janar 2007. Më 28 dhjetor 2010, AKP-ja kishte kryer identifikimin e pronës në kërkesën nr. KPA19201 duke bërë publikimin e saj në Gazetën Njoftuese nr. 10. Gjithashtu, lista ishte publikuar në dy pjesë të ndryshme të Dushanovës, në Gjykatën Komunale, Zyrën Kadastrale, Komunën e Prizrenit dhe në rajon. Pala përgjegjëse në ankesë 2 pretendonte interesin ligjor duke thënë se ai kishte blerë pronën nga vëllezërit Ç. dhe pastaj ia kishte shitur atë palës përgjegjëse në ankesë 2.
6. Për të mbështetur kërkesat e tyre, palët përgjegjëse në ankesë kishin prezantuar dokumentet vijuese:
 - Autorizimin nr. II-757/2003 të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Kragujevc më 25 dhjetor 2003 me anë të së cilit J.S. e kishte autorizuar A.S. të ndërmerre të gjitha veprimet e nevojshme për shitjen dhe bartjen e të drejtave pronësore në emër të palës së tretë për ngastrat 518/1, 518/2, 518/4, 519/1 dhe 519/2, të regjistruara në fletën poseduese nr.78.
 - Deklaratën për shitjen vullnetare të pronës Vr.nr. II-758/2003 të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Kragujevc më 25 dhjetor 2003 me të cilën J.S. deklaroi se ngastrat e regjistruara në fletën poseduese nr. 78 mund të shiten në bazë të autorizimit të dhënë për A.S.
 - Kontratën mbi shitblerjen e pronës Vr.Nr.421/2004 të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prizrenit të datës 29 janar 2004. Kontrata ishte lidhur në mes të J.S. në cilësinë e shitësit dhe O.C., M.C., H.C., M.C., në cilësinë e blerësve të ngastrave 518/1, 518/2, 518/4, 519/1, 519/2 të regjistruara në fletën poseduese nr.78.

- Fletën poseduese nr. 78 të lëshuar nga Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Prizrenit më 22 shtator 2004 në emër të O.C., M.C., H.C., M.C., të cilët figurojnë si pronarë.
 - Kontratën mbi shitblerjen të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prizrenit Vr.Nr.4377/2004 të datës 23 shtator 2004. Kontrata ishte lidhur në mes të O.C., M.C., H.C., M.C., si shitës të ngastrave 518/1, 518/2, 518/4, 519/1 dhe 519/2 dhe palës përgjegjëse në ankesë 2 si blerës.
 - Kontratën mbi shitblerjen të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prizrenit Leg.Nr.984/2009, të datës 19 shkurt 2009. Kontrata ishte lidhur në mes të palës përgjegjëse në ankesë 2 si shitës i ngastrave 518/1, 518/2, 518/4 dhe Shemsedin Berishës si blerës.
 - Vendimin 027.nr.389/B të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, të datës 20 shkurt 2009, me anë të së cilit kërkesa e Sh.B. ishte miratuar, ku ai kishte kërkuar bartjen e të drejtave të tij pronësore në emrin e tij.
 - Kontratën mbi shitblerjen të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prizrenit Leg. Nr. 7972/2010, të datës 14 shkurt 2010. Kontrata ishte lidhur në mes të A.B. si shitës i ngastrave 518/1, 518/2, 518/4, 519/1 dhe 519/2 dhe D.Xh. s si blerës.
7. Më 11 qershor 2013, KKPK, me vendimin e tij KPCC/D/A/204/2013, kishte hedhur poshtë kërkesat bazuar në nenin 18 të Rregullores së UNMIK 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50). Në arsyetimin e tij, KKPK ka theksuar se pala ankuese kishte dorëzuar *inter alia* dokumentet që kishin të bënin me një procedurë penale që ishte në vazhdim e që ishte iniciuar nga prokurori publik më 1 qershor 2005. Kjo procedurë ka të bëjë me një falsifikim të pretenduar të Autorizimit të lëshuar nga J.S.. Autorizimi ishte baza për bartjen e pronave të kërkuara në emrat e palëve të treta në vitin 2004 dhe më vonë për rishitjen e pronave të kërkuara. KKPK për më shumë kishte theksuar se procedura gjyqësore gjithashtu përfshin vendosjen lidhur me të drejtën pronësore për pronat e kërkuara dhe kishte filluar para datës 16 tetor 2006, datë kjo kur kishte hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50. Prandaj, KKPK kishte hedhur poshtë kërkesat.
 8. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese më 4 nëntor 2013. Më 2 dhjetor 2013, pala ankuese ka paraqitur ankesë.
 9. Palët përgjegjëse në ankesë kishin marrë vendimin më 14 dhe 19 nëntor 2013 ndërsa ankesën më 11 prill 2014. Palët përgjegjëse në ankesë nuk kanë paraqitur përgjigje në ankesë.

Pretendimet e palëve*Pala ankuese*

10. Pala ankuese thekson se vendimi i KKPK-së përmban gabime thelbësore apo shkelje të rënda të së drejtës materiale dhe se vendimi mbështetet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
11. Pala ankuese thekson se nëna e tij është pronare dhe poseduese ligjore e pronave të kërkuara dhe se këto të drejta ishin humbur për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur që kishte ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99.
12. Sipas palës ankuese, AKP/KKPK ka kompetencë ekskluzive për të vendosur lidhur me kërkesën e tij sepse ajo është në përputhje të plotë me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Ai nuk e ka dërguar kërkesën e njëjtë në gjykatën kompetente para apo pas hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.
13. Pala ankuese thekson se procedura që është duke u zhvilluar në Gjykatën e Kragujevcit nuk mund të merret si procedurë e cila në përputhje me nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 do të përjashtonte juridiksionin e AKP/KKPK-së sepse ajo është procedurë penale e iniciuar kundër M.M. dhe M.D.dhe jo procedurë civile për anulimin e kontratës të lidhur mbi bazën e autorizimit të falsifikuar.
14. Në fund, pala ankuese thekson se AKP/KKPK, ngjashëm me nenin 4 të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, është i autorizuar të shpallë të pavlefshme çdo kontratë për bartjen e pronës së paluajtshme që është lidhur nëpërmjet mashtrimit si dhe çfarëdo të hyrash nga shitje të tilla.

Palët përgjegjëse në ankesë

15. Para KKPK-së palët përgjegjëse në ankesë kishin theksuar se pala përgjegjëse në ankesë 2 kishte blerë pronat e kërkuara më 23 shtator 2004 nga O.C., M.C., H.C., M.C., dhe se më vonë, më 19 shkurt 2009, ai ia kishte shitur pronat e kërkuara palës përgjegjëse në ankesë 1. Pala përgjegjëse në ankesë 1 më 27 tetor 2009 ia kishte dhënë pronat e kërkuara birit të tij A. dhe në vitin 2010 biri i tij ia kishte shitur pronat e kërkuara D.Xh. .

Arsyetimi ligjor*Pranueshmëria e ankesave*

16. Ankesat janë të pranueshme. Ato janë paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

Bashkimi i ankesave

17. Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 parasheh që Gjykata Supreme mund të vendos mbi bashkimin apo shkrirjen e ankesave, kur një bashkim apo shkrirje e tillë e kërkesave është vendosur nga KKPK në përputhje me nenin 11.3 (a) të ligjit. Ky nen e lejon KKPK-në të marrë në konsideratë bashkimin apo shkrirjen e kërkesave në mënyrë që të shqyrtoj dhe marrë vendime kur ka çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave. Edhe pse KKPK zyrtarisht nuk i ka bashkuar kërkesat, AKP dhe KKPK i ka proceduar katër kërkesat dhe të gjitha provat e dorëzuara lidhur me katër kërkesat së bashku dhe ka ofruar një arsyetim të përbashkët për katër kërkesat.

18. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK) (nr. 03/L-006) janë të aplikueshme në procedurën ankimore para Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Neni 408.1 lidhur me nenin 193 të LPK-së, parasheh mundësinë e bashkimit të të gjitha kërkesave përmes një aktvendimi nëse kjo do të siguronte efektivitetin dhe efikasitetin e gjykatës lidhur me lëndën.

19. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën ankesa përkatëse është paraqitur, faktet, baza ligjore dhe çështjet e provave janë tërësisht të njëjta në të 4 (katër) lëndët. Vetëm ngastrat, subjekt i të drejtës pronësore e cila pretendohet në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë shpjeguese dhe mbi dokumentacionin e njëjtë. Gjithashtu, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjti.

20. Prandaj Gjykata Supreme ka vendosur të bashkoj ankesat siç theksohet në paragrafin një të dispozitivit.

Meritat

21. Pasi që KKPK ka mbështetur vendimin e tij për të hedhur poshtë kërkesën në nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe pala ankuese kundërshton atë arsyetim, pyetja e parë që duhet të merr përgjigje nga Gjykata Supreme është nëse KKPK me të drejtë ka ardhur te ai konstatim.

22. Neni 18 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 thotë:

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për çdo kërkesë nga neni 3.1 i kësaj Rregulloreje që është parashtruar pranë gjykatës me kompetencë territoriale, me kusht që procedura gjyqësore lidhur me kërkesën e tillë të mos ketë filluar para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

23. Sipas praktikës juridike të zbatuar nga Gjykata Supreme (vide p.sh., Aktgjykimi nr. GSK-KLPA-A-230/2013 i datës 21 nëntor 2014,) *a contrario* ndaj kësaj dispozite KKPK nuk ka juridiksion të vendos lidhur me kërkesën kur e njëjta kërkesë tashmë ka qenë në pritje të zgjidhjes në gjykatën kompetente para hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

24. Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 thotë – për aq sa është relevante -:

AKP (...) përmes KKPK ka kompetenca për t'i zgjidhur (...) kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999: (a) Kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe (b) Kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, ku paditësi aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore.

25. Siç rezulton nga dokumentet e dorëzuara nga pala ankuese dhe që gjithashtu nuk kundërshtohet, nëna e palës ankuese gjatë luftës ka qenë pronare, bartëse e së drejtës pronësore, e pronës së kërkuar dhe në vitin 1999 ajo kishte humbur posedimin mbi pronat e kërkuara për shkak të rrethanave që kanë rezultuar nga konflikti i armatosur.

26. Pyetja që duhet të marrë përgjigje është nëse subjekti i procedurës penale në Kragujevc, Serbi, është kërkesa nga neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 që është paraqitur në gjykatën kompetente para datës 16 tetor 2006, data e hyrjes në fuqi të asaj rregulloreje.

27. Siç thekson pala ankuese, sipas aktgjyqimeve të gjykatave të Kragujevcit, aktakuza në procedurën penale i referohet veprës penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare. Të pandehurit akuzohen për shkaktim të dëmit dhe shkeljen e të drejtave të nënës së palës ankuese përmes përdorimit të Autorizimit të rrejtshëm dhe regjistrimit të këtij dokumenti të rrejtshëm si të vërtetë në Regjistrin e Vërtetimeve të Gjykatës Komunale të Kragujevcit dhe përpilimit të Kontratës mbi shitjen e pronave të kërkuara bazuar në këtë autorizim të rrejtshëm. Gjatë procedurës Gjykata Komunale e Kragujevcit ka lëshuar më 30 tetor 2006 masën e përkohshme për të parandaluar tjetërsimin e

pronave të kërkuara nga pala e tretë që gjoja kishte blerë pronat e kërkuara'. Në aktgjykimin (e prishur) të shkallës së parë, nënës së palës ankuese si palë e dëmtuar i ishte miratuar 'kërkesa pronësore juridike në shumën prej 9.627.618 Dinarësh, ndërsa kur është fjala për kërkesat e tjera pala e dëmtuar është udhëzuar për në kontest civil.

28. Përveç tjerash, KKPK-ja ka konstatuar se kjo kërkesë e palës së dëmtuar nuk është kërkesë siç parashihet me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Së pari, shitja (e falsifikuar) në vitin 2004 nuk ndërlidhet drejtpërdrejtë dhe as nuk rezulton nga konflikti i armatosur i viteve 1998/1999, pasi që falsifikimi ishte bërë në vitet 2003/2004. Së dyti, KKPK-ja në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 ka kompetencën të zgjidh kërkesat pronësore dhe të siguroj kthimin e pronës në formë të ri-posedimit të pronës apo një zgjidhje tjetër, kompensimit apo urdhrave të logjikshëm siç shihen të nevojshëm për ta mundësuar bartësin e të drejtës pronësore që në mënyrën e duhur të ushtroj të drejtat e tij/saj pronësore. KKPK nuk mund të pranoj kërkesat për kompensim (financiar). (Vide: Neni 2.1 i Urdhërësës Administrative nr. 2007/5 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 të Shtojcës I të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 8.6 i Shtojcës III të asaj Urdhërese Administrative.) Gjykata Penale në Kragujevc mund të ofroj kompensim financiar për nënën e palës ankuese si palë e dëmtuar nga shpërdorimi i pozitës zyrtare por si gjykatë penale jashtë Kosovës ajo gjykatë nuk mund të lëshon një urdhër për ri-posedim apo të ofroj zgjidhje të tjera, kompensim apo urdhra logjik të domosdoshëm për ta mundësuar bartësin e së drejtës pronësore që në mënyrën e duhur të ushtroj të drejtat e tij/saj pronësore me efekt civil ligjor për pronën që gjendet në Kosovë. Prandaj, procedura penale në Serbi nuk mund të marrë përsipër kompetencën e KKPK-së për të vendosur mbi kërkesat siç janë paraqitur nga pala ankuese para AKP/KKPK edhe kur duhet të vendoset se procedurat penale ishin iniciuar para datës 16 tetor 2006, datë kjo e hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.
29. Kjo do të thotë se vendimi i KKPK-së nuk mund të qëndroj dhe ankesa duhet të pranohet si e bazuar.
30. Gjykata Supreme mund të vendos lidhur me kërkesën gjithashtu. Është evidente se nëna e palës ankuese ishte pronare e pronave të kërkuara. Palët përgjegjëse në ankesë i janë referuar Kontratës mbi shitblerjen të vërtetuar më 29 janar 2004 për të mbështetur qëndrimin e tyre se nëna e palës ankuese nuk është më pronare e pronave të kërkuara. Ky argument nuk është më i efektshëm. Kjo kontratë nuk përmbush bartjen e vlefshme të të drejtave pronësore të nënës të palës ankuese sepse Autorizimi është i rrejshëm dhe rrjedhimisht jo i vlefshëm. Kjo del nga

raporti 'Të Gjeturat e Ekspertit' nga L.L., Ekspert i Gjykatës në fushën e Grafologjisë dhe Traseologjisë në Beograd, të datës 28 prill 2005 dhe gjithashtu nga fakti se Autorizimi ishte tërhequr tashmë në vitin 2003 para se të lidhej Kontrata mbi shitblerjen në janar 2004. Kontrata mbi shitblerjen e vërtetuar më 29 janar 2004 duhet të mos merret parasysh dhe gjithashtu edhe kontratat pasuese për bartjen e pronave të kërkuara sepse ato nuk janë mbështetur mbi të drejtën e vlefshme pronësore nga shitësit pasues.

31. Nga ajo që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 pika (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

32. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Anders Cedhagen, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it